

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO



Republika e Kosovës / Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 400105-20852
Data/Datum 02.08.2021

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2021

Dt. 29.07.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.07.2021, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për ndarjen e Subvencioneve në vlerë 10.000€ KFC “Vëllaznimi”, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës për ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 10,000,€ për Klubin e Futbollit KFC “Vëllaznimi” nga Gjakova .
2. Mjetet financiare në vlerë prej 10,000€ të merren nga kategoria e subvencioneve Komunale.
3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve gjatë realizimit të veprimtarisë Sportive të KFC “Vëllaznimi” në Gjakovë .
4. Shuma e mjeteve financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të jetë nga Tepricat e Subvencioneve .
5. Obligohen Organet e Administratës Komunale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve Financiare sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, dhe të derdhen në xhirollogarinë e Klubit Futbollistik KFC “Vëllaznimi” .
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa
 - Klubit të Futbollit KFC “Vëllaznimi” .
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,

Z. Anton Shala